



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

PËRPUNIM DRURI

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

C-IV-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit.....	4
Kodi	4
Kohëzgjatja.....	4
Niveli.....	4
Qëllimi:.....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi:.....	4
Ofruesit	5
Data e validimit	5
Data e miratimit	5
Variantet e mëparshme	5
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	6
NjN-03-IV-0001-24 Planifikim, organizim dhe mbikëqyrje e procesit të prodhimit në përpunim druri	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit.....	7
NjN-03-IV-0002-24 Sigurimi i cilësisë së punimeve në përpunim druri.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit.....	9
NjN-03-IV-0003-24 Mirëmbajtje e makinerive dhe instrumenteve prerës të përpunim drurit	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit.....	10
NjN-03-IV-0004-24 Procesi i tharjes të lëndës drunore	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit.....	11
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit.....	13
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit.....	14
NjN-03-IV-0007-24 Mbikëqyrja e zbatimit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në përpunim druri	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit.....	15
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:.....	15
Modalitetet e vlerësimit	16
Informacion shtesë	16
SHËNIM	17

Emërtimi i kualifikimit	PËRPUNIM DRURI			Kodi
	Kohëzgjatja	Niveli	IV KSHK, referuar niveli IV të KEK	
	900-1100 orë ³			C-IV-24
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Përpunim druri” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, është të përgatitë individët me aftësi praktike, për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me përpunimin e drurit, si specialistë të nivelit teknik/menaxher, për menaxhimin e një brigade, reparti, linjë prodhimi, apo krijimin e menaxhimin e një biznesi privat.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Përpunim druri” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që: – kanë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të “Përpunim druri”, niveli III (KSHK), referuar niveli III të KEK. – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. – <u>kanë aftësi ndryshe</u>, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Përpunim druri” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli si teknik/menaxher i mesëm në këtë kualifikim profesional. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në institucione të ndryshme shtetërore dhe shoqëri private, me aktivitet në sektorin e përpunimit të drurit, teknik i mesëm prodhimi i një njësie prodhuese të objekteve dhe konstruksioneve prej druri, produkteve gjysmë të gatshme, restaurues, arredues, si dhe në njësi të shitjes së materialeve dhe produkteve të drurit, etj. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual të prodhimit, shitjes apo ekspozimit të materialeve dhe produkteve në fushën e përpunim drurit. Përfundimi me sukses i këtij kualifikimi profesional i jep të drejtën individit për të fituar diplomën e “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.			

³ Orë mësimore 45 minuta

Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.
Data e validimit	
Data e miratimit	
Variantet e mëparshme	C-III-16

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Përpunim druri”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas fushave të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitet e të nxënësve.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij prodhuese;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente;
4. Të ndër marrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, të jetë i matur dhe i sjellshëm me eporet, vartësit, partneret, etj;
9. Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
10. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
11. Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
12. Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese;
13. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;

14. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
15. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
16. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
17. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
18. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
19. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
20. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
21. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-03-IV-0001-24 Planifikim, organizim dhe mbikëqyrje e procesit të prodhimit në përpunim druri

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të interpretojë plan-vendosjet e reparteve dhe njësive të prodhimeve/shërbimeve, si dhe skemat e furnizimit me energji, uji, etj.;
2. Të përshkruajë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin/menaxhimin e grupeve të veçanta në varësi të procesit të punës që ato kryejnë;
3. Të përshkruajë standardet e produkteve me bazë druri dhe rregulloret teknike kombëtare dhe ndërkombëtare;
4. Të përshkruajë mënyrën e hartimit, dokumentimit të porosive dhe projekteve nga palët e treta dhe argumentimin e tyre;
5. Të përshkruajë nevojat për burime njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse për realizimin e proceseve të ndryshme;
6. Të përshkruajë mënyrën e hartimit të urdhrave të punës, të kartave teknologjike të thjeshta të prodhimit/shërbimit, të kontrollit teknik operacional dhe atij përfundimtar, etj.;
7. Të shpjegojë rëndësinë e normativave të punës për çdo fazë të procesit të prodhimit;
8. Të analizojë vizatimet e objekteve prej druri.
9. Të shpjegojë mënyrën e zbërthimit, detajimit të objektit sipas radhës, vendosjen e përmasave dhe mbipërmasave, si dhe hartimin e kartës shoqëruese /teknologjike;
10. Të shpjegojë vizatimin teknik manual dhe digjital (CAD, Autocad, Scatchup) si dhe programe ECXEL për preventiva;
11. Të shpjegojë teknikat e përpunimit të drurit dhe materialet me bazë druri;
12. Të shpjegojë mjetet, pajisjet, makineritë e ndryshme, të transportit dhe instrumentet prerës, funksioni dhe përdorimi i tyre;
13. Të shpjegojë mënyrat e përcaktimit të prodhimtarisë së makinerive dhe pajisjeve, sipas karakteristikave teknike të tyre;
14. Të interpretojë parametrat teknologjikë të lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse (vetitë fizike, kimike, teknologjike dhe mekanike);

15. Të shpjegojë mënyrën e përcaktimit të rezervës së nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse, apo prodhime gjysmë të gatshme etj.), për ecurinë e proceseve të punës;
16. Të përshkruajë mënyrën e mbikëqyrjes së procesit të prodhimit;
17. Të përshkruajë mënyrat e sigurimit të makinerive, mjeteve, pajisjeve, instrumenteve, materialeve të përpunimit të drurit;
18. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
19. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të depozitës së lëndës së parë dhe ndihmëse;
20. Të shpjegojë mënyrat e matjes së lëndës së parë dhe asaj ndihmëse me mjete dhe instrumente përkatëse;
21. Të përshkruajë proceset teknologjike të prodhimit të produkteve me bazë druri;
22. Të përshkruajë mënyrat e mbikëqyrjes së performancës së makinerive, saktësisë të punimit dhe të regjistrimit të instrumenteve prerës;
23. Të përshkruajë mënyrat e mbikëqyrjes së funksionimit normal të sistemeve të transportit të brendshëm dhe atyre të aspirimit;
24. Të shpjegojë funksionalitetin dhe përdorimin e pajisjeve të kontrollit;
25. Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip, sipas proceseve përkatëse të punës;
26. Të shpjegojë e rëndësinë kontrollit të pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës dhe makinerive;
27. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me teknikë dhe specialistë të tjerë;
28. Të shpjegojë mënyrat e raportimit të eprorët;
29. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së performancës së stafit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë infrastrukturën teknike referuar fluksit teknologjik të prodhimit;
2. Të hartojë dhe menaxhojë dokumentacionin teknik;
3. Të menaxhojë burimet njerëzore;
4. Të menaxhojë pajisjet, mjetet dhe makineritë;
5. Të menaxhojë lëndët e para, ndihmëse dhe burimet e tjera të nevojshme për realizimin e proceseve të punës.

Kriteret e vlerësimit

- Zbërthen plan-vendosjet e reparteve dhe njësive të prodhimeve/shërbimeve, si dhe skemat e furnizimit me energji, uji, etj. sipas projektit teknologjik;
- Organizon dhe koordinon punën për drejtimin/menaxhimin e grupeve të veçanta në varësi të fluksit teknologjik;
- Përcakton radhën e punës sipas procesit teknologjik të produkteve me bazë druri edhe restaurimeve;
- Përcakton normativat e punës për çdo fazë të procesit të prodhimit në bashkëpunim me inxhinierin e zbatimit të punimeve, sipas projektit teknologjik;
- Zbërthen objektet komplekse prej druri në detale të veçanta, sipas kartave respektive teknologjike;

- Mbikëqyr proceset e prodhimit, sipas kartës teknologjike duke respektuar standardet e produkteve me bazë druri dhe rregulloret teknike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Respekton teknikat e përpunimit të drurit dhe materialeve me bazë druri, sipas standardeve dhe specifikimeve teknike të projektit;
- Vizaton skicën e objektit, zbërthen në elemente, vendos përmasat dhe mbipërmasat, si dhe harton kartën shoqëruese/teknologjike, sipas standardeve;
- Përdor programe kompjuterike (p.sh. CAD, Autocad, Sketchup, ECXEL etj.) për vizatime dhe dokumentime, sipas kërkesave;
- Dokumenton porosi dhe projekte nga palë të treta, sipas kërkesës;
- Harton urdhra punë të thjeshta të prodhimit/shërbimit, të kontrollit teknik operacional dhe atij përfundimtar etj., sipas kartës teknologjike;
- Planifikon dhe përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse për realizimin e proceseve të ndryshme;
- Ndan detyrat në ekip, sipas kualifikimeve përkatëse;
- Bashkëpunon me teknikë dhe specialistë të tjerë sipas procesit të punës;
- Informon eprorët për ecurinë në repartin e prodhimit, sipas kërkesës dhe formatit;
- Mbikëqyr performancën e stafit, sipas rregullove të brendshme;
- Planifikon mjetet, pajisjet, makineritë e ndryshme, të transportit dhe instrumentet prerës sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Përcakton prodhimtarinë e makinerive dhe pajisjeve, sipas karakteristikave teknike të tyre;
- Mbikëqyr kontrollin e funksionimit të makinerive, pajisjeve të kontrollit, saktësinë e punimit dhe regjistrimit të instrumenteve prerës, sipas manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr funksionimin e sistemeve të transportit të brendshëm dhe atyre të aspirimit, sipas manualeve përkatëse;
- Kontrollon pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës dhe makinerive në përfundim të punës, sipas rregullores së brendshme;
- Planifikon lëndën e parë, ndihmëse dhe rezervën e nevojshme, sipas parametrave të kërkuara (vetitë fizike, kimike, teknologjike dhe mekanike) dhe objektit të prodhimit;
- Siguron lëndën e parë, ndihmëse dhe burimet e tjera të nevojshme për përpunimin të drurit, sipas planit të prodhimit;
- Mbikëqyr organizimin e depozitës së lëndës së parë dhe ndihmëse, sipas rregullores;
- Mbikëqyr procese pune të matjes së lëndës së parë dhe ndihmëse me mjete dhe instrumente përkatëse, sipas standardit;
- Përdor në mënyrë racionale lëndët e para, ndihmëse dhe burimet e tjera të nevojshme për minimizimin e kostove.

NjN-03-IV-0002-24 Sigurimi i cilësisë së punimeve në përpunim druri

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e cilësisë së punimeve të kryera në fushën e përpunimit të drurit;
2. Të përshkruajë metodat e ndryshme të kontrollit të fushën e përpunimit të druri sipas standardit, skicave, modeleve etj.;
3. Të shpjegojë ndërtimin dhe përdorimin e mjeteve dhe aparateve matëse e kontrolluese të

- cilësisë së punimeve, në të gjithë sektorët e punimit të drurit;
4. Të shpjegojë mënyrën e monitorimit të punës gjatë proceseve të përpunimit të drurit;
 5. Të shpjegojë defektet që mund të lindin gjatë operacioneve përpunuese në makineri apo pajisje dhe mënyrën e shmangies dhe riparimit të tyre;
 6. Të shpjegojë llojet e ambalazhimeve, paketimeve, marketimit dhe magazinimit si dhe rolin e tyre në funksion të cilësisë.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të sigurojë cilësinë e proceseve të punës në fushën e përpunimit të drurit;
2. Të sigurojë cilësinë e produktit;

Kriteret e vlerësimit

- Përcakton metodat e kontrollit në fushën e përpunimit të druri sipas standardit, skicave, modeleve etj.;
- Përdor mjete dhe aparate matëse e kontrolluese të kolauduara sipas manuale përkatëse;
- Siguron realizimin me cilësi të proceseve të punës, sipas standardeve;
- Kontrollon cilësinë e punimeve të kryera, sipas kartës teknologjike;
- Kontrollon cilësinë e lëndës së parë dhe ndihmëse, sipas parametrave të kërkuar;
- Kontrollon cilësinë e produktit, sipas standardit;
- Identifikon defektin në produkt, sipas rastit;
- Përcakton shkaqet e defektit, sipas llojit.
- Merr masa për eliminimin e defektit, sipas llojit të procesit dhe në kohë sa më të shkurtër.

NjN-03-IV-0003-24 Mirëmbajtje e makinerive dhe instrumenteve prerës të përpunim drurit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mënyrat e parashikimit të defekteve gjatë funksionimit të makinerive dhe mjeteve të punës;
2. Të përshkruajë llojet e defekteve të pajisjeve, makinerive dhe instrumenteve prerës, si dhe riparimet bazë të tyre;
3. Të shpjegojë teknikat e mirëmbajtjes së makinerive dhe instrumenteve prerës;
4. Të përshkruajë mënyrat e parashikimit të defekteve të mundshme gjatë funksionimit të sistemeve të transportit të brendshëm;
5. Të përshkruajë mënyrat e identifikimit të shkaqeve të defekteve në makineri apo pajisje;
6. Të përshkruajë mënyrat e identifikimit të shkaqeve të defekteve në sistemet e transportit të brendshëm;
7. Të përshkruajë organizmin e punës për riparimin e defekteve;
8. Të shpjegojë kalendarin e shërbimeve të mirëmbajtjes së pajisjeve, makinerive dhe instrumenteve prerës;
9. Të përshkruajë hartimin e dokumentacionit të nevojshëm mbi dëmtimet/riparimet që ndodhin në repart.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë mirëmbajtje të makinerive, pajisjeve, instrumenteve prerëse dhe kontrolluese;
2. Të kryejë riparime të thjeshta të makinerive, pajisjeve, instrumenteve prerëse, kontrolluese dhe sistemeve të transportit.

Kriteret e vlerësimit

- Harton planet e remontit periodik dhe vjetor për makineritë, pajisjet, impiantet duke parashikuar koston për kryerjen e remonteve;
- Realizon mirëmbajtje dhe shërbime të thjeshta të makinerive, pajisjeve dhe impianteve, sipas manualeve përkatëse;
- Kryen mirëmbajtje dhe shërbime të thjeshta të instrumenteve prerëse dhe kontrolluese, sipas manualeve përkatëse;
- Dokumenton proceset dhe afatet e mirëmbajtjes së makinerive, pajisjeve, impianteve dhe instrumenteve prerëse e kontrolluese, sipas formateve;
- Parashikon defekte të mundshme të makinerive, pajisjeve, instrumenteve prerëse, kontrolluese dhe sistemeve të transportit, bazuar në performancën aktuale të punimit të tyre;
- Përcakton defektet e thjeshta të makinerive, pajisjeve, instrumenteve prerëse, kontrolluese dhe sistemeve të transportit, si dhe parregullsitë në kryerjen e punimeve, sipas rastit dhe manualeve përkatëse;
- Përcakton shkaqet e defektit dhe merr masa për eliminimin e tij, sipas manualeve;
- Raporton në kohë reale çdo defekt ose mosfunksionim normal të makinerive, pajisjeve, instrumenteve prerës, kontrolluese dhe sistemeve të transportit;
- Koordinon punën e repartit me specialistët e mirëmbajtjes për riparimin e defekteve, sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton defektin dhe riparimet e kryera, sipas formateve.

NjN-03-IV-0004-24 Procesi i tharjes të lëndës drunore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e ndarjes dhe stivimit të materialit drunor sipas llojit, trashësisë, gjerësisë dhe gjatësisë;
2. Të shpjegojë marrëdhëniet e përmbajtjes së lagështisë në dru me vetitë dhe performancën;
3. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së sasisë të avullit të nevojshëm për tharje;
4. Të shpjegojë mënyrat dhe metodat e tharjes së materialit drusor;
5. Të përshkruajë specifikat e organizimit të tharjes natyrale;
6. Të shpjegojë impiantet e tharjes, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
7. Të listojë llojet e kaldajave, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
8. Të shpjegojë kriteret e përzgjedhjes së regjimit të tharjes së lëndës drunore, duke analizuar parametrat përkatës;
9. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së prodhimtarisë në tharëse;

10. Të listojë instrumentet dhe pajisjet e kontrollit të regjimit të tharjes, funksioni dhe përdorimi i tyre;
11. Të shpjegojë mënyrat e identifikimit të defekteve të tharjes dhe shkaqet e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë procesin e tharjes së lëndës drunore.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr ndarjen dhe stivimin e materialit drusor sipas llojit, trashësisë, gjerësisë dhe gjatësisë;
- Mbikëqyr përcaktimin e lagështisë në dru, sipas standardit;
- Përzgjedh mënyrat dhe metodat e tharjes së materialit drusor, sipas parametrave të lëndës drusore;
- Përcakton kriteret e përzgjedhjes së regjimit të tharjes së lëndës drusore, duke analizuar parametrat përkatës;
- Llogarit sasinë e avullit të nevojshëm për tharje, sipas regjimit të tharjes;
- Llogarit prodhimin në tharëse, sipas kapacitetit të tharëses;
- Përzgjedh instrumentet dhe pajisjet e kontrollit të regjimit të tharjes, sipas funksionit të tyre;
- Organizon tharjen natyrale, sipas kushteve teknike;
- Monitoron procesin e tharjes në impiantet dhe kaldajat, sipas regjimit të caktuar;
- Identifikon defektet në tharje, shkaqet dhe mënyrën e evitimit të tyre.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

2. Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
3. Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
4. Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
5. Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare, etj.);
6. Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
7. Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
8. Të përshkruajë metodat e menaxhimit të problemeve të ndryshme;
9. Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
10. Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale, vendore, rajonale dhe globale;
11. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit të aftësive personale dhe nevojën për kualifikime të vazhdueshme;
12. Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;

13. Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritetit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
14. Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
15. Të shpjegojë dobinë e marketingut në biznes;
16. Të shpjegojë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
17. Të listojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së përpunimit të drurit;
18. Të shpjegojë mënyrat e hartimit të grafikut të kohës së punës;
19. Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
20. Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit të faturave;
21. Të shpjegojë mënyrën e marrjes së informacionit mbi çmimet e tregut të materialeve bazuar në standardet e përpunimit të drurit;
22. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostos të materialeve të një shërbimi;
23. Të listojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
24. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
25. Të shpjegojë elementet e llogaritjes e çmimit përfundimtare për punimet/shërbimet e ofruara;
26. Të listojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve dhe mënyra e përgatitjes së tyre;
27. Të shpjegojë teknikat e duhura të marketingut për punimet/shërbimet që kryen;
28. Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
29. Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita;
30. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos së prodhimit/shërbimit të një produkti të caktuar, kostot direkte dhe indirekte, (që përfshijnë koston e materialeve kryesore, të materialeve ndihmëse, mjeteve, pajisjeve e instrumenteve etj., të shpenzimeve direkte dhe indirekte, deri në magazinimin e produktit të gatshëm etj.);
31. Të përshkruajë konceptin e normimit e punës, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri ose pajisje;
32. Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit të produktit/shërbimit, arredimit, restaurimit, etj. (koston e përcaktuar, fitimin e menduar, afatin e realizimit, sasinë e kërkuar, kërkesën e tregut, çmimin /ofertën e tregut për atë produkt/shërbim ose produkte të ngjashme, cilësitë ose karakteristikat e veçanta të produktit/shërbimit, garancinë, kushtet për mirëmbajtjen, transportin, etj.);
33. Të interpretojë çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse që përdoren në njësitë e përpunim drurit, arredimeve, restaurimeve, etj., sipas veçorisë së tyre;
34. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së rendimentit të prodhimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë detyrat administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të zhvillohet profesionalisht.

Kriteret e vlerësimit

1. Zbaton kodin e punës dhe legjislacionin në fuqi;
2. Plotëson planin e punës në përputhje me detyrën e dhënë;
3. Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike (llogarit koston) referuar projekteve specifike;
4. Zbaton grafikun e punës sipas proceseve që duhen realizuar dhe fuqisë punëtore në dispozicion;
5. Kryen blerjen e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme;
6. Përzgjedh furnitorët referuar cilësisë së produkteve që ofrojnë, çmimeve përkatëse dhe performancës së shërbimit;
7. Menaxhon burimet financiare në dispozicion;
8. Llogarit rendimentin e operacioneve të prodhimit, si dhe analizon faktorët përcaktues të tij;
9. Harton dokumentacionin referuar marrëdhënies me klientët dhe furnitorët;
10. Harton dokumentacionin referuar performancës në punë të vartësve, si dhe merr masa për motivimin e tyre në punë;
11. Zbaton teknikat e marketingut për produktet me baze druri;
12. Përgatit oferta për produktet apo shërbimet sipas çmimeve aktuale të tregut;
13. Mbledh informacion mbi tregun e produkteve me baze druri dhe marketingun e tyre;
14. Kryen trajnime për zhvillimin profesional dhe të karrierës;
15. Përdor teknologjinë bashkëkohore për aftësim referuar realizimit të proceseve të punës;
16. Informon në kohë bashkëpunëtorët për zbatimin e teknikave të reja në industrinë përpunimit të drurit;
17. Realizon pjesëmarrje aktive në panaire apo aktivitete të tjera tregtare, prodhuese apo edhe shkencore (inovacione) me qëllim përftim informacioni mbi teknologjitë bashkëkohore dhe rritjen e nivelit profesional;
18. Harton plane dhe realizon aktivitete për rritjen e nivelit profesional të vartësve.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë të informimit dhe komunikimit;
2. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të metodave të duhura në komunikim;
3. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit në mënyrë korrekte të parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me klientët;
5. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
6. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë së qartë në komunikim, me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës profesionale;
8. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të veprimit apo komunikimit sipas parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
9. Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së informacionit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
3. Të përdorë terminologji të qartë në komunikim, me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës profesionale.

Kriteret e vlerësimit

- Aplikon teknologjitë e reja të informacionit për një komunikim efektiv;
- Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të reja të ditës;
- Zbaton parimet e punës në grup;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët.
- Respekton kodin e etikës në mënyrë korrekte;
- Pozicionohet me objektivitet për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve që evidentohen gjatë punës;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Zbaton rregullat e etikës së komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët, kolegët dhe të tjerë;
- Ruan me efikasitet informacionin e klasifikuar;
- Përdor saktë terminologjinë profesionale me kolegët dhe të tjerët;
- Harton dokumentacionin e nevojshëm kundrejt rregullave zyrtare drejtshkrimore;
- Imponon kolegët të përdorin saktë terminologjinë profesionale dhe rregullat drejtshkrimore zyrtare.

NjN-03-IV-0007-24 Mbikëqyrja e zbatimit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në përpunim druri

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet kryesore të standardit ISO 45001, për sigurinë në punë;
2. Të shpjegojë parimet kryesore të standardit dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
3. Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
4. Të përshkruajë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
5. Të interpretojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
6. Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
7. Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve dhe impianteve të MZSH;
8. Të shpjegojë masat përkatëse dhe pajisjet që nevojiten gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
9. Të shpjegojë mjetet e ndihmës së parë dhe përdorimin e tyre;
10. Të shpjegojë përdorimin e veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse kolektive dhe individuale;

11. Të përshkruajë operacionet me rrezikshmërinë më të lartë për aksidente në punë;
12. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste pandemie;
13. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
14. Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
15. Të shpjegojë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
16. Të shpjegojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
17. Të përshkruajë legjislacionin në vendosjen e repartit/fabrikës të përpunimit të drurit ndaj zonës së banuar;
18. Të listojë llojet e mundshme të aksidenteve në fushën e përpunimit të drurit dhe mënyrën e shmangies së tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë standardet e sigurimit teknik në punë;
2. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit;
3. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit

- Monitoron zbatimin e legjislacionit në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Monitoron vlefshmërinë dhe menaxhon dokumentacionin e sigurimit teknik dhe të raporteve të vlerësimit të riskut referuar aksidenteve në punë;
- Monitoron gatishmërinë e sistemeve dhe pajisjeve të MZSH-se;
- Harton dhe teston planin e veprimit në rast të rënies së zjarrit në objekt;
- Monitoron vendosjen e sinjalistikës përkatëse;
- Monitoron masat e sigurisë në punë;
- Kryen trajnime dhe testime periodike të stafit në lidhje me rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Monitoron zbatimin e rregullave për parandalimin e aksidenteve;
- Zbaton procedurat për dhënien e ndihmës së parë;
- Zbaton procedurat për evakuim në rast emergjencash;
- Zbaton protokollet e duhura në rastet e ngjarjeve ekstreme;
- Zbaton rregullat e higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;
- Menaxhon dokumentacionin mbi kontrollin periodik shëndetësor të stafit.
- Zbaton procedurat e mbrojtjes së mjedisit;
- Zbaton rregullat e përdorimit efikas të burimeve të lëndëve të para dhe atyre të energjisë;
- Zbaton udhëzimet teknike për ruajtjen dhe përdorimin e materialeve referuar minimizimit të rrezikut për ndotjen e mjedisit;
- Zbaton procedurat e ruajtjes dhe grumbullimit të mbetjeve;
- Zbaton procedurat për ndarjen e mbetjeve sipas llojit.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikim, organizim dhe mbikëqyrje e procesit të prodhimit në përpunim druri	25	NjN-03-IV-0001-24
2	Sigurimi i cilësisë së punimeve në përpunim druri	15	NjN-03-IV-0002-24
3	Mirëmbajtje e makinerive dhe instrumenteve prerës të përpunim drurit	15	NjN-03-IV-0003-24
4	Procesi i tharjes të lëndës drunore	15	NjN-03-IV-0004-24
5	Komunikimi dhe etika profesionale	10	NjN-22-IV-0006-24
6	Sipërmarrje dhe edukim karriere	5	NjN-23-IV-0005-24
7	Mbikëqyrja e zbatimit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në përpunim druri	15	NjN-03-IV-0007-24
	Totali	100 %	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **C-IV-24**

C - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-03-IV-0001-24**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

03 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0001 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit